



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.293/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur lidhur me ankesën e Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe INTERNEËS KOSOVA (IKS), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit LDK-AKR, me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore gjatë ditës së votimit, me vendosjen e posterave në afersi të qendrës se votimit 100 m, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 13.06.2017, mori këtë:

#### V E N D I M

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa Anr.293/2017 e datës 12.06.2017, me të cilën është pretenduar se kandidati për deputet **Arben Gashi**, nga **Koalicioni LDK-AKR**, ka thyer heshtjen zgjedhore me vendosjen e posterëve në afersi të qendrës se vendvotimit, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore.

#### A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës, BIRN/IKS, me seli në Prishtinë, me datën 12.06.2017, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se gjatë ditës së heshtjes zgjedhore, kandidati për deputet **Arben Gashi**, nga **Koalicioni LDK-AKR**, ka vazhduar me vendosjen e posterave prej 89 hapa në largësi të qendrës së vendvotimit në Fakultetin Filologjik, në Prishtinë edhe në ditën e heshtjes zgjedhore. Më këtë rast pretendohet se është bërë thyerje e heshtjes zgjedhore, të përcaktuar me LZP.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografive të bashkangjitura, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### Ankesa është e pabazuar

Parashtruesi i ankesës me ankesën e tij pretendon se në afersi të qendrës së votimit në Fakultetin Filologjik, në Prishtinë, monitoruesi i tyre ka hasur një poster reklamuese të kandidatit për deputet nga koalicioni LDK-AKR, të ngjitur në hapësirë publike dhe në afersi më pak se 100 metra nga qendra e votimit.

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë te qarta dhe bindëse edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim te nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, për të provuar se shkelësi i supozuar e ka shkelur heshtjen zgjedhore me vendosjen e posterive në afërsi të vendvotimit. Nga prova e ofruar nuk mund të vërtetohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se ku gjendet qendra e votimit siç pretendohet në ankesë dhe se posteri i kandidatit në fjalë është i vendosur më afër se 100 m, nga qendra e vendvotimit.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.293 /2017 më datën 13.06.2017

**Kryesuesi i Panelit**  
Fejzullah Rexhepi



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.